Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 9 qershor 2012

Lëndët nr. 49/08 dhe 50/08

Svetisllav KRSTIQ dhe Stana KRSTIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 9 qershor 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, vendosë si në vijim

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesat e z. dhe znj. Krstiq janë parashtruar më 2 tetor 2008 dhe janë regjistruar më 21 nëntor 2008.

2. Më 6 prill 2009 dhe 26 gusht 2009, Paneli kërkoi nga znj. Krstiq të jep informata shtesë. Znj. Krstiq u përgjigj përmes letrës së datës 10 shtator 2009.

3. Më 8 prill 2009, Paneli kërkoi informata nga Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Më 26 gusht 2009 kërkoi edhe informata të tjera. Dhoma e posaçme nuk është përgjigjur në këto letra.

4. Më 6 mars 2012, Paneli kontaktoi ankuesit përmes telefonit dhe morri informatat të tjera nga ata.

5. Më 29 mars 2012, Paneli kërkoi informata nga Agjencia e Privatizimit e Kosovës (AKP). AKP-ja u përgjigj më 30 prill 2012.

II. FAKTET

6. Ankuesit janë ish-banorë të Kosovës që tani për tani jetojnë në Serbi. Ata deklarojnë se në qershor të vitit 1999 iu ishte dashur të dalin nga Kosova për shkaqe të sigurisë. Pas daljes së tyre, ata më nuk ka qenë në gjendje ta vazhdojnë punën në ndërmarrjen shoqërore "Silosi dhe Fab. E Bukes"/"Poslovanje i aktiva DP Silosi i Fab. hleba" në fshatin Xërxë të komunës së Rahovecit (më tutje në tekst: Silosi), ku kanë qenë më parë të punësuar. Ata gjithashtu thonë se që atëherë nuk kanë marrë ndonjë pagë apo kompensim tjetër nga Silosi.

Faktet për privatizimin e Silosit

7. Pasi që kuptuan se Silosi po privatizohej, ankuesit parashtruan kërkesë në një datë të paspecifikuar tek Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKM) për t'u përfshirë në mesin e punëtorëve që konsiderohen se kanë të drejtë për marrjen e 20%-shit nga të hyrat e privatizimit.

8. Më 11 qershor 2005, AKM-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në marrjen e 20 %-shit të të hyrave nga privatizimi i Silosit, por ankuesit nuk kanë qenë të përfshirë në listë.

9. Ankuesit parashtruan ankesë ndaj vendimit të AKM-së në Dhomën e Posaçme. Më 24 tetor 2006, Dhoma e Posaçme shpalli kërkesëpaditë e tyre si të papranueshme për shkak të faktit se autorizimet, të cilat përfaqësuesi i tyre ligjor ia paraqiti Dhomës së Posaçme nuk ishin të verifikuara si duhet. Në përputhje me ligjin e aplikueshëm në atë kohë, vendimi i Dhomës së posaçme ka qenë i formës së prerë.

10. Megjithatë, në letrën e datës 20 mars 2008 që z. Krstiq ia dërgoi AKM-së, ku thoshte se pasi që ishte informuar për problemin formal të autorizimit, ai ia dorëzoi përfaqësuesit të tij ligjor autorizimin e verifikuar në mënyrë të duhur. Ai deklaroi se asnjëherë nuk ka marrë përgjigje në atë letër.

11. Në letrën e datës 30 prill 2012, AKP-ja, agjencia pasuese e AKM-së, njoftoi Panelin se mes ankuesve dhe AKM-AKP-së është duke u zhvilluar procedura.

Faktet lidhur me pretendimin për pagat e papaguara

12. Në data të paspecifikuara, ankuesit kanë parashtruar kërkesë tek AKM-ja, përmes të cilës kërkonin pagesën e pagave të papaguara. Dokumentet e parashtruara nga ankuesit tregojnë se kërkesat e tyre janë i janë përcjellë AKM-së nga Zyra e UNMIK-ut në Beograd më 25 gusht 2006. Më 31 gusht 2006, ata ia dorëzuan AKM-së informatat shtesë.

13. Më 19 shkurt 2007, AKM-ja kërkoi nga ankuesit që të qartësojnë kërkesat e tyre. Në përgjigjen e dërguar përmes letrës së datës 9 mars 2007, z. Krstiq ia shpjegoi AKM-së natyrën e kërkesës së tij.

14. Më 18 qershor 2010, Komisioni përkatës i likuidimit i AKP-së refuzoi si të pabaza kërkesat e ankuesit për pagat e papaguara. Në letrën e lartpërmendur të datës 30 prill 2012 (shih § 11 më lartë), AKP-ja informoi Panelin se vendimet nuk i janë dorëzuar ankuesve për shkak të vështirësive mes shërbimit postar të Kosovës dhe atij të Serbisë.

III. ANKESAT

15. Ankuesit deklarojnë se Dhoma e posaçme ka refuzuar kërkesëpaditë e tyre lidhur me të hyrat nga privatizimi i Silosit në bazë të lëshimit formal, i cili lehtësisht ka mundur të korrigjohet po qe se ata do të udhëzoheshin ta bënin një gjë të tillë. Në thelb, ata ankohen për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë para një tribunali të paanshëm, të drejtës së pronës, të drejtës për mjet të efektshëm juridik dhe të drejtës për të mos u diskriminuar.

16. Ata thirren në një numër dispozitash të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut, të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut

IV. BASHKIMI I ANKESAVE

17. Në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së vet të punës, Paneli vendosi t'i bashkojë të dy ankesat.

V. LIGJI

18. Para shqyrtimit të lëndës për bazueshmërinë e saj, Paneli fillimisht duhet të vendosë nëse duhet të pranohet lënda apo jo, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të parapara në nenin 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

A. Ankesat lidhur me pjesën e të hyrave nga privatizimi

19. Në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli mund të shqyrtojë çështjen vetëm brenda gjashtë muajve nga marrja e vendimit të formës së prerë. Qëllimi i rregullës së afatit gjashtëmujor është rritja e sigurisë ligjore dhe sigurimi që lëndët,

përmes të cilave ngritën çështje në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të trajtohen brenda një kohe të arsyeshme (shih, për shembull, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), *Opuz kundër Turqisë*, nr. 33401/02, aktgjykim i datës 9 qershor 2009, § 110).

20. Në rastet kur ankuesi apo përfaqësuesi i tij ka pranuar kopjen me shkrim të vendimit të formës së prerë, objekti i qëllimit të kushtit për afatin gjashtëmujor arrihet më së miri, duke llogaritur periudhën gjashtëmujore nga data e dorëzimit të vendimit me shkrim (GjEDNj, *Worm kundër Austrisë*, aktgjykim i datës 29 gusht 1997, *Raporte të aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1997-V, f. 1547, § 33).

21. Paneli thekson se nga parashtresat e ankueses drejtuar Panelit nuk është e qartë se kur ata ose përfaqësuesit e tyre kanë marrë kopjet me shkrim të vendimeve të lartpërmendura të Dhomës së posaçme, të dyja të datës 24 tetor 2006 (shih § 9 më lartë). Megjithatë, është e qartë se ankuesit kanë ditur për këto vendime deri më datën 20 mars 2008, kur z. Krstiq i shkroi letër AKM-së (shih § 10 më lartë).

22. Paneli thekson se ankesat janë parashtruar më 2 tetor 2008, gjegjësisht pothuajse dy vjet pas lëshimit të vendimeve të lartpërmendura të Dhomës së Posaçme dhe më shumë se gjashtë muaj pas dërgimit të letrës së z. Krstiq AKM-së.

23. Rrjedhimisht, kjo pjesë e ankesave mbetet jashtë afatit kohor prej gjashtë muajve, të paraparë në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

B. Procedura lidhur me pagat e papaguara

24. Edhe pse ankuesit nuk ankohen formalisht për procedurat lidhur me kërkesëpaditë e tyre për pagat e papaguara për periudhën kur nuk kanë qenë në gjendje të punojnë në Silosi, Paneli thekson se ata kanë parashtruar disa dokumente lidhur me këto kërkesëpadi. Rrjedhimisht, e konsideron të duhur që të shqyrtojë se a ka arsye që të merr parasysh atë ankesë në vetvete.

25. Në bazë të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli ka juridiksion ndaj ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u.

26. Paneli thekson se ankuesit me siguri nuk janë në dijeni për vendimet e AKP-së për refuzimin e kërkesave të tyre, sepse ata nuk kanë qenë të njoftuar për këto vendime. Megjithatë, AKP-ja është një institucion i themeluar nga autoritete e Kosovës. AKP-ja ka marrë përsipër funksionet që më parë i ka ushtruar AKM-ja (shih raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të datës 24 nëntor 2008, S/2008/692, § 20).

27. Çfarëdo vendimi i AKP-së mund t'i atribuohet vetëm autoriteteve të Kosovës. Në këtë rast, nuk ka indikacion tp ndonjë përfshirjeje konkrete të UNMIK-ut në marrjen e atij qëndrimi. Andaj, mund tp vihet në përfundim se vendimet e AKP-së nuk krijojnë përgjegjësi për UNMIK-un (shih Paneli kështillëdhënës për të drejta të njeriut, *Bojkoviq*, nr. 42/10, vendim i datës 17 shkurt 2012, § 11).

28. Rrjedhimisht, Paneli nuk ka mundësi të shqyrtojë nëse vendimet e AKP-së janë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

SHPALL ANKESAT TË PAPRANUESHME.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues